



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHENDETËSISË
MINISTRI



100 Vjet Pavarësi

Adresa: Blv. "Bajram Curri" Tirana, Albania, tel / fax. + 355 4 362937- www.moh.gov.al

Nr. **4889** .Prot.

Tiranë me, **16.11** .2012

URDHËR

Nr. **580** , Datë **16.11** .2012

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SHERBIMIN E SHENDETIT ORAL NE
REPUBLIKEN E SHQIPERISE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 7 pika 4 e ligjit Nr 9000 datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave,

URDHËROJ

1. Miratimin e rregullores për shërbimin e shëndetit oral ne Republikën e Shqipërisë që i bashkelidhet këtij urdhëri.
2. Rregullorja Nr. 356 datë 08.07.2004 "Për shërbimin e shëndetit oral", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

VANGJEL TAVO





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

RREGULLORE

**“PËR SHERBIMIN E SHENDETIT ORAL NE REPUBLIKEN E
SHQIPERISE”**

MIRATUAR

ME URDHRIN NR. 580, DATË 16 / 11 /2012.

TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË

TIRANË, 2012

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja "Për shërbimin e shëndetit oral në Republikën e Shqipërisë" hartohet në zbatim të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.9928, datë 9.6.2008 "Për shërbimin shëndetësorë stomatologjik në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të rregullojë organizimin dhe funksionimin e të gjitha institucioneve shëndetësore stomatologjike, shtetërore dhe private.

Neni 3

Organizimi

1. Shërbimi i shëndetit oral është i organizuar në:
 - a. Shërbimi publik, i cili përfaqëson shërbimin e shëndetit oral të ofruar nga institucionet shëndetësore publike.
 - b. Shërbimi privat, i cili përfaqëson shërbimin e shëndetit oral të ofruar nga subjekte fizike / juridike private të licensuara.
2. Shërbimi i shëndetit oral ofrohet nga:
 - a- Kabineti Dentar
 - b- Klinika Dentare
 - c- Laboratori Dentar
 - d- Kabineti radiologjik

Neni 4

Kabineti Dentar

Kabineti dentar eshte njesia baze e sherbimit te shendetit oral, ku kryhen ekzaminime, diagnostikime dhe nderhyrje parandaluese e kuruese te patollogjive, apo anomalite e indeve te forta dhe te buta te gojes.

Neni 5

Kushtet Fizike dhe Higjenosantare te Kabinetit

1. Kabineti perbehet nga :

- a) ambjenti i punes
- b) ambjenti i pritjes
- c) tualeti.

2. Kabineti eshte i organizuar si me poshte:

- | | |
|--------------------------------------|-----------------------------------|
| a) Siperfaqja e ambjentit te punes : | jo me pak se 12 m ² |
| b) Lartesia e dhomes: | jo me pak se 2.8 m ² . |
| c) Siperfaqja e ambjentit te pritjes | jo me pak se 6 m ² . |
| d) Siperfaqja e tualetit | jo me pak se 4 m ² |
| e) Siperfaqe totale | 22 m ² |

3. Ndricimi duhet te jete natyral dhe nepermjet energjise elektrike.

4. Furnizim i vazhdueshem me uje te ngrohte dhe te ftohte.

5. Desifektimi i pajisjeve te punes para dhe pas cdo seance.

6. Per sterilizimin e veglave te punes duhet te kete autoklave e cila mund vendoset ne ambientin e punes ose ne nje ambient te posaqem .

7. Per te eliminuar mundesine e perhapjes se infeksioneve kerkohet largimi i mbeturinave dhe materjaleve te perdorura mjekesore sipas kushteve te percaktuara ne rregulloren per «Mbetjet spitalore».

8. Uniforma e personelit mjeksor perbehet nga perparese ose kostum mjeksore, doreza, kapuc, maske si edhe syze plastike.

9. Ne rastet kur njesia dentare ngrihet ne godina banimi, respektohen rregullat e ndersjellta me fqinjat: eleminimi i zhurmave, mbajtja paster e ambienteve me perdorim te perbashket, etj.

Neni 6 Klinika

1. Klinika e ofrimit të shërbimit të shëndetit oral përbehet nga jo më pak se dy kabine të punës

Neni 7 Kushtet Fizike dhe Higjienosanitare të Klinikës

- a) Klinika nuk duhet të jetë më e vogël se 45 m²
- b) Klinika Dentare duhet të jetë e ndarë në 2 ose më shumë ambiente të punës të cilat duhet të jenë të ndara nga njëra – tjetra duke ruajtur kushtet fizike dhe Higjieno-Sanitare të përcaktuara në nenin 5.
- c) Për çdo ambient të punës shtesë respektohen parametrat e sipërfaqes dhe lartësive të përcaktuara në nenin 5 pikë 2 .

Neni 8

Personeli i kabineve/ klinikave të shërbimit Stomatologjik

1. Në kabinet/klinike punësohen mjekë stomatolog të përgjithshëm ose të specializuar në fusha të ndryshme të stomatologjisë të pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit nga Urdhëri i Mjekut në Republikën e Shqipërisë.
2. Në kabinet/klinike mund të punësohen infermierë, laborantë të cilët kanë kryer arsimin përkatës dhe janë të pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit nga urdhëri i profesionistëve.
3. Në kabinet/klinike mund të punësohet personel ndihmës si: sekretarë, punonjës sanitar etj.

Neni 9 Pajisjet e Kabinetit dhe Klinikës

- 1 - Uniti dentar me pjesët përberëse të tij
 - Karige e mjekut
 - Karige e asistentit
 - Tavolina e punës.
- 2 - Mobilimi plotësues në varesi të nevojave.
- 3 - Instrumentat e punës sipas specialitetit me një minimum prej 15 kompletësh diagnostikimi.
- 4 - Preparatet dhe medikamentet për ndihmën e shpejtë.

- 5 - Pajisje per dezinfektim dhe sterilizim.
- 6 - Kabineti /Klinika te jetë e pajisur me masa për mbrojtjen kundër zjarrit (fikëse zjarri).

Neni 10

Dokumentacioni per kabinet / klinike

1. Dokumentacioni qe duhet te disponoje njesia e sherbimit te shendetit oral publik eshte:

- a- Kartele e pacientit
- b- Rregjistri i punes
- c- Dokumentacioni vertetues per sterilizimin e instrumentave te punes.
- d- Programi i promocionit dhe edukimit shendetesor.

2. Dokumentacioni qe duhet te disponoje njesia e sherbimit te shendetit oral privat eshte:

- a- Dokumentin e regjistrimit te biznesit ne organin perkates.
- b- Licensen e aktivitetit te leshuar nga institucioni perkates .
- c- Leje e ushtrimit te profesionit, i leshuar nga Urdhri i Mjekut, per drejtuesin teknik dhe personelin stomatolog te punesuar, te jete i afishuar dukshem.
- d- Kontraten e punes per personelin stomatolog dhe ndihmes.
- e- Leja higjeno sanitare te leshuar nga institucioni perkates.
- f- Librezat shendetesore te personelit stomatolog dhe ndihmes.
- g- Kartelen e pacientit duke siguruar pacënushmërinë, aksesin, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave
- h- Listen e cmimeve te afishuara ne sallen e pritjes

Neni 11

Laboratori

Laboratori perfaqeson sherbimin ne te cilin kryhen punimet e ndryshme protetike dentare. Laboratori mund te ngrihet prane institucioneve te tjera te sherbimit te shendetit oral, ose mund te jete i pavarur.

Neni 12

Kushtet Fizike dhe Higjeno- Sanitare te laboratorit

- 1 Laboratori ka jo me pak se 2 ambjente pune

- a- Ambjent per perpunimin e metalit
- b- Ambjent per perpunim e materialit estetik

2. Ambjentet e punes duhet te kene sipërfaqe jo me pak se 10 m² secili.
3. Ambjenti i perpunimit te metalit, duhet te jete i vecante dhe e pajisur me aspiratore.
4. Aparatet duhen te jene te pajisur me silenciator, per te ulur nivelin e Zhurmave.
5. Materialet, aparaturat dhe pajisjet, te cilat paraqesin rrezikshmeri per shendetin e personelit, mbahen ne ambjente te vecanta, duke respektuar rregullat perkatese te sigurise.
6. Uniforma e Laborantit dentar perbehet nga perparse pune, syze , kapuc dhe doreza.

Neni 13

Personeli i Laboratorit

1. Ne laborator duhet te punojne laborantë të cilët kanë kryer arsimin përkatës dhe jane te pajisur me lejen e ushtrimit te profesionit nga urdheri i profesionisteve.
2. Ne laborator mund te punesohet personel ndihmes si: punonjes sanitar etj.

Neni 14

Kabineti radiologjik i shendetit oral

1. Kabineti radiologjik i shendetit oral perfaqeson njesine ne te cilen kryhen vetem ekzaminime radiologjike te indeve te buta dhe te forta te gojes intraoral dhe extraoral (PANORAMEX). Për kabinetet/qendra shëndetësore në të cilat janë instaluar pajisje radiologjike që emetojnë rrezatim zbatohen rregullorja për kabinetet radiologjike.
2. Hapja dhe funksionimi i kabinetit radiologjik, behet ne zbatim te ligjit Nr. 8025 dt.09/11/1995 "Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" i ndryshuar dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij.

Neni 15

Organet e kontrollit

1. Organet te cilat kane te drejten te ushtrojne kontroll jane:
 - a- Inspektoriati Qendror
 - b- Inspektoriati Shendetesor Shteteror.
 - c- Zyra e mbrojtjes nga rrezatimi.

Neni 16

Dispozita Mbyllëse

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen te gjitha institucionet publike dhe private qe ofrojne sherbime te shendetit oral.
2. Per monitorimin e zbatimit te kesaj rregullorje ngarkohet Drejtoria Shendetit Publik ne Ministrine e Shendetesise.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha rregulloret dhe udhëzuesit e mëparshme që trajtojnë shendetin oral.